



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 112-25010

Dt: 06.05.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040 dhe Përfundimit 01 nr.06-12359-6/1 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve me dt: 09.03.2016, me të cilin është miratuar kërkesa e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për formimin Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumenteve të përfituesve të grandeve, me dt: 06.05.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për përfituesit e grantit të subvencioneve të Drejtorisë për Zhvillimin Ekonomik, në këtë përbërje:

1. Kelmned Vula, kryesues i Komisionit
2. Lulzim Jupa, anëtar
3. Zeqir Karakushi, anëtar
4. Selman Sahiti, anëtar
5. Mirlinda Sada, anëtare

2. Komisioni i përshkruar në pikën paraprake duhet të angazhohet për kryerjen e veprimeve si në vijim:

- Shqyrtimi i dokumentacionit të aplikuesëve ;
- Përzgjedhja preliminare e aplikacioneve të cilat i plotësojnë pikët për tu kualifikuar për fazën e vizitës në terren dhe shqyrtimeve përfundimtare;
- Vizita në terren e bizneseve të kualifikuara në bazë të shqyrtimit të aplikacioneve .
- Shqyrtimi i pikëve në bazë të vizitës në terren;
- Përpilimi i listës me emrat e përfituesve të përzgjedhur;
- Takimi i Komisionit në mbledhje periodike, në varësi të numrit të aplikacioneve që do të rishikohen, për të diskutuar, finalizuar dhe konsoliduar vlerësimet për të përcaktuar rezultatet përfundimtare të aplikantëve ;
- Rekomandimi për aprovimin e grantit do të bëhet në bazë të rezultateve më të larta të aplikacionit;
- Komisioni në përfundim të punës do të nënshkruaj raportin me listën përfundimtare të përfituesve të grantit të subvencioneve .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila

